




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-03/22
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	28.02.2022
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së tretë (3) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 28.02.2022, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. **Shpejtim Gacaferi**: i cili në fillim përshëndeti kryetarin e Komunës: z. Ruzhdi Shehun, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, Komandantin e stacionit të Policisë në Junik z. Rasim Sylja, Drejtorin e QKMF-së në Junik z. Ali Kuqi, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit.

Anëtarët prezent

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Albertina Gacaferi - Anëtare, LDK
5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. Eliza Pepshi- Anëtare, LVV
14. Xhemë Tofaj-Anëtar, LVV

Mungon: Lulzim Gacaferi-Anëtar, LVV

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Formimi i Grupit punues për hartimin e planit të punës të Kuvendit Komunal, për vitin 2022
3. Raporti i Buxhetit Komunal për vitin 2021,
4. Rishiqimi i propozimit për Komitetin për Komunitete
5. Informatë nga gjendja e tanishme me Covid -19 në Komunën e Junikut,
6. Me kërksen e kryetarit të Komunës pikë shtesë, nxjerrja e vendimit për formimin e Komisionit të KKS-së
7. Të ndryshme.

z. Shpejtim Gacaferi: Kërkoj nga Anëtarët e Kuvendit Komunal që pikën pestë ta vendosim në pikën e dytë Informatën nga gjendja e tanishme me Covid -19 në Komunën e Junikut, për shkak të agjendës së ngarkuar të z. Ali Kuqi. A jeni të pajtimit me këtë ndryshim të rendit të ditës?

E hedhi në votim këtë rend të ditës.

Nga 14 prezent, për ishin 14, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Pika e parë e rendit të ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara

z. Shpejtim Gacaferi: Sa i përket pikës së parë të rendit të ditës, materialet i keni përpara a ka dikush sa i për këtë procesverbalit që ka diskutuar, dhe nuk i është shënuar diskutimi? E hedhi në votim.

Nga 14 prezent, për ishin 14, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Pika e dytë e rendit të ditës

2. Informatë nga gjendja e tanishme me Covid -19 në Komunën e Junikut,

z. Shpejtim Gacaferi: Fjalën e kaloj të kryetari i Komunës së Junikut z. Ruzhdi Shehu.

z. Ruzhdi Shehu: Kryetari fillimisht përshëndeti Komandantin e stacionit të Policisë në Junik z. Rasim Sylja, Drejtorin e QKMF-së në Junik z. Ali Kuqi, anëtarët të Kuvendit Komunal,

Nënkryetarin e Komunës, Drejtorët, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit. Fillimisht unë mendoj, se në bazë të informatave të përgatitura nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i keni të prezantuar lidhur me menaxhimin e pandemisë në Komunën e Junikut pa humbur kohë fjalën e kalojmë te drejtori i QKMF-së z. Ali Kuqi meqë e kemi prezent.

z. Ali Kuqi: Falemderit Kryesues, përshëndetje për Kryetarin dhe të gjithë të pranishmit, sa i përket gjendjes pandemike me COVID-19 në Komunën e Junikut gjatë muajit janar dhe muajit shkurt kemi pasur një numër të madh të infektuar të qytetarëve ne kemi punuar me kapacitet të cilat i kemi edhe pse me mungesë të stafit por na gëzon fakti që nuk kemi pasur pacient të hospitalizuar dhe asnjë rast vdekje zyrtarisht të infektuar me Covid -19. Nga 5 janari e deri me tani i kemi pas 150 raste të qytetarëve të infektuar me COVID-19, prej tyre 120 prej tyre kanë qenë pozitiv të Komunës së Junikut nga mosha 8 vjeçare deri ne moshën 80 vjeçare nuk janë kursyer asnjë grup moshë, vlen të përmendet vendimi që është marrë në shtabin emergjent që shkollat e Komunës së Junikut nga varianti A kanë kaluar në variantin C, mësim online në distancë ku kemi treguar rezultat pozitiv, sepse është këputur “zingjiri i ftoftë” për këtë periudhë, edhe pse numri i pacientëve ka qenë në numër të madh. Ne jemi munduar t’iu ofrojmë shërbime dhe me barna esenciale, edhe pse kemi pasur edhe mungesa të furnizimit, kësaj here pacientët e kanë kaluar me simptome me të lehta falë vaksinimit të qytetarëve ku janë të vaksinuar me dozën e parë 2240, me dozën dytë. 130 persona, jemi duke vazhduar me personat me dozën e tretë. 450 persona, ku për dozën e tretë kemi një përgjigje shumë të ulët nga qytetarët për tu vaksinuar me këtë dozë, ekipi i vaksinimit janë në kryerjen e detyrës në nivelin e duhur. gjatë krejt javës që e lamë pas i kemi pasur vetëm gjashtë raste për tu vaksinuar përgjigja për vaksinim është shumë e ulët . Ne ditën e premte i kemi pasur ne vizitë anëtarët e komitetit të vaksinimit në kuadër të Ministrisë Shëndetësisë, ku jemi vlerësuar shumë mirë sa i përket menaxhimit të situatës me COVID -19 në Komunën e Junikut, si dhe ne zbatimin e rekomandimeve të IKPSHP-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë. E kemi edhe raportin ku janë ndarë shumë të kënaqur edhe ne menaxhimin e të “zingjirit të ftoftë”, ne si QKMF jemi në nivelin e duhur por gjithmonë ka vend për përmirësime. Ne si QKMF dorëzojmë kërkesa të vazhdueshme për barna esenciale në Ministrinë e Shëndetësisë, po shpresojmë që të na miratohen për përkrahje. Gjatë kësaj periudhe kemi pasur ne vizitë edhe komisionin parlamentar për shëndetësi ku i kemi informuar rreth procesit të menaxhimit të pandemisë me COVID -19.

Gjatë vitit 2020 Kuvendi Komunal ka nxjerrë vendimin për mbështetjen e qytetarëve të prekur me COVID-19 me nga 100 euro si ndihma për pacientët e prekur, por atëherë ka qenë numri i të infektuarve në numër më të vogël dhe nuk kanë qenë të vaksinuar, ndërsa tani ka numër të madh të pacienteve të prekur me COVID-19 dhe ju si Komun sa keni kapacitete për ti mbuluar këto shpenzime ku tani kostoja e mjekimit është shumë e vogël, sepse qytetarët janë të vaksinuar dhe imunizuar unë konsideroj që ju si Asamble Komunale ta rishikoni këtë vendim sepse konsideroj që nuk është e nevojshme që të vazhdohet, unë kaq kisha sa i për këtë kësaj pike, pres pyetje nga ju nëse keni.

z. Shpejtim Gacaferi: Falënderoj Doktorin e QKMF-së z. Ali Kuqin për informatën. Fjalën e kaloj të z. Leonard Lolluni.

z. Leonard Lolluni: Falemderit kryesues përshëndetje për të gjithë, e dëgjova me vëmendje Doktorin lidhur me informatën në QKMF. Dr. Ali Hoxha në Junik, mirëpo nuk pajtona me dy pika; pika e parë që e potencoj që duhet të shfuqizohet vendimi për përkrahjen e qytetarëve të prekur me COVID-19 i nxjerr nga Asambleja Komunale, nuk është në kompetencën e Drejtorit të QKMF-qe të propozon për shfuqizimin të vendimit në fjalë, por mund të propozohet nga kryetari i Komunës dhe votohet për ndryshim nga Asambleja Komunale, dhe pika e dytë ju raportuat që nuk kemi pasur raste të vdekjes ku para dy ditëve në lagjen “Bajraktar” ka vdekur një person i prekur nga COVID-19.

z. Ali Kuqi: Sa i përket shfuqizimit të vendimit për të prekurit me COVID-19 nuk e thash që të shfuqizohet por të rishqyrtohet, sepse ishte veq si propozim i imi edhe ju si deputet mund të bëni propozime, sa i përket rastit të vdekjes me COVID-19 në lagjen “Bajraktar” unë po flas me raporte zyrtare deri më tani nuk kemi raport zyrtar për raste të vdekjes nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë. Unë i referona vetëm informatave zyrtare.

z. Dervish Bajraktari: Falemderit kryesues përshëndetje për te gjithë, dua të drejtoj një kërkesë te Drejtori i QKMF-së, rastisa javën e kaluar ne laboratorin në Junik sepse e pata familjarin të prekur me COVID-19 shkuam për ti bërë analizat, por nuk arritëm sepse na than qe nuk kemi material për të bërë testin, andaj ju lusë që të bëni të pamundurën që të furnizoheni me materialin e nevojshëm për analiza që mos ti detyrojmë qytetarët e Junikut të shkojnë ti bëjnë analizat në labore private apo në Komuna tjera.

z. Ali Kuqi: Sa i përket furnizimit me material, ne i kemi të proceduar kërkesat e laboratorit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Drejtorinë komunale të shëndetësisë. Sa ne i posedojmë informatat; Drejtorja e ka dërguar kërkesën ne zyrën e Prokurimit por duhet te presim deri të hapet tenderi, kjo pasojë na ka përcjellë qe nga viti i kaluar sepse nuk e kemi pasur asnjë furnizim në QKMF sa i përket reagencave te laboratorit dy herë ka dështuar tenderi për furnizime, sepse operoret ekonomik nuk janë treguar të përgjegjshëm dhe ka pasur ankesa, keni të drejtë për momentin nuk jemi duke ofruar shërbime laboratorike për qytetar përveç testit të COVID-19 po shpresojmë qe ne afatin sa me te shpejt të nënshkruhet kontrata për furnizime.

z. Leonard Lolluni: Drejtor e kam një pyetje a është e vërtetë qe në QKMF nuk ka aparat për mbatjen e tensionit të gjakut, sepse e kam informatën para dy ditëve ka shkuar një pacient dhe i është thënë nga doktori qe nuk është duke me funksionuar aparati për matjen e tensionit të gjakut.

z. Ali Kuqi: Se cili mjek qe shërben në QKMF e posedon aparatin personal për matjen e tensionit të gjakut perveq tyre është në dispozicion edhe aparati i QKMF-së, unë konsideroj se kjo informatë nuk qëndron, mund të jetë vetëm thash e theme.

z. Zenel Maloku: Përshëndetje për të gjithë ne veçanti për Drejtorin e QKMF-së; me gëzon fakti se sot ka gjetur kohë dhe është prezent, sepse unë kam kërkuar disa herë që ta kemi prezent në çdo takim. Një pyetje për mjekun, analizat për qytetarët perse nuk janë duke u bërë në QKMF e Junikut dhe qytetarët po duhet të detyrohen të dëmtohen me mjete të veta të shkojnë ti bëjnë analizat në laboratorët private; besa edhe shumë kush nuk i ka kushtet për ti bërë këto analiza.

z. Ali Kuqi: Falemderit unë e kam përshtypjen që në QKMF duhet të bëhen të gjitha analizat por Ministria e Shëndetësisë e ka nxjerr një udhëzim administrativ që 36 analiza të behen në QKMF në Junik, por vitin e kaluar në kemi arritur që të gjitha këto analizat ti bëjmë për qytetarët, vitin e kaluar po ashtu kemi pasur ankesa nga qytetarët perse nuk po behen analizat që e konfirmojnë virusin, Ministria e Shëndetësisë i ka zgjedhur gjashtë Komuna të mëdha që t'iu ofron shërbim qytetarëve për këto analiza tjera, është kërkuar nga mjekët që të bëhet analiza për trashjen e gjakut ku në nuk kemi pasur mundësinë që në QKMF ta bëjmë këtë analizë, kjo analizë nuk bëhet as në QKUK.

Pika e tretë e rendit të ditës

3. Formimi i Grupit punues për hartimin e projekt planit të punës të Kuvendit Komunal për vitin 2022

z. Shpejtim Gacaferi: Në bazë të rregullores së Kuvendit Komunal dhe Statusit të Komunës së Junikut për qdo vit kërkohet që ta ketë planin punës, sa i përket përbërjes së grupit punues kryesuesi i Kuvendit shkon direkt, dhe unë kam menduar që të tri partitë politike në Kuvend të përfaqësohen me nga një anëtar dhe nga ekzekutivi një anëtar. Fjalën e kaloj të grupet e partive politike për propozime.

z. Sadri Krasniqi: falemderit kryesues në grupi i LDK-së pajtohem dhe për anëtare propozojmë znj. Albertina Gacaferi.

z. Leonard Lolluni: Në si grup i AAK-së e propozojmë znj. Erleta Qestaj.

z. Xhemë Tofaj : Grupi i LVV-së e propozojmë znj. Eliza Pepshi.

z. Shpejtim Gacaferi: Nga ekzekutivi e propozoj Drejtoreshën nga Administrata e përgjithshme znj. Leonora Shehu.

E hedhi në votim propozimet.

Nga 14 prezent; për ishin 14, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Pika e katërt e rendit të ditës

3. Raporti i Buxhetit Komunal për vitin 2021,

z. Shpejtim Gacaferi: Sa i përket kësaj pike është detyrë që të raportohet raporti i buxhetit për çdo vit, ndërsa ne do ta bëjmë raportimin e buxhetit për çdo tre muaj, nga kryetari i Komunës, për këtë pikë fjalën e kaloj të kryetari i Komunës së Junikut z. Ruzhdi Shehu.

Ruzhdi Shehu: Faleminderit kryesues sa i përket raportit të buxhetit për vitin 2021 është planifikuar edhe për këtë vit dhe shpenzuar nga qeveria e kaluar, por sa i përket kësaj informate unë do ta kaloj fjalën të zytari kryesor financiar z. Arten Hamza pasi që është akteri kryesor për rrjedhën e parasë në Komunën e Junikut, sa i përket buxhetit për vitin 2021.

z. Arten Hamza: Falemnderit Kryesues përshëndetje për ju kryetar dhe të gjithë të pranishmit, sa i përket raportit të buxhetit të vitit 2021 kërkohet në baza periodike ti raportohet Kuvendit lidhur me ecurinë e te hyrave dhe rrjedhjen e buxhetit kë raportim është hera e katërt që po raportohet, ju materialin e gjerë e keni secili por ne pika të shkurtra do të mundohem të sqaroj.

Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesve prezantohet për 14 programet buxhetore :

1. Zyra e Kryetarit
2. Kuvendi Komunal
3. Administrata e Përgjithshme
4. Buxhet dhe Financa
5. Zhvillim Ekonomik
6. Shërbimet publike dhe Inspeksion
7. Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis
8. ZKK (Zyra Komunale për Komunitete)
9. Shëndetësi
10. Mirëqenie Sociale
11. Shërbimet e kujdesit primar
12. Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
13. Arsimi i mesëm
14. Arsimi fillor.

Gjithashtu kemi pas rritje te buxhet me vendimin e qeverise se Kosovës për punëtorët e arsimit, shëndetësisë, punëtorët e socialit zjarrfikësit, si kompensime shtesë për menaxhimin e pandemisë me Covid-19, që janë vazhduar deri ne rishikimin e buxhetit, kemi pasur edhe ndryshime në kategorinë e pagave ku një inspektor nga niveli komunal është bartur ne kompetencën e nivelit qendror ku ne kemi te zvogëluar një staf në komune, ka ndodhur bartja e te hyrave ku janë transferuar ne investime kapitale. Ne kategorinë e pagave ne fund te vitit me vendimin e qeverisë janë zvogëluar kategoria e pagave ku tepricat neper kategori janë marr dhe janë transferuar aty ku ka pas minuse ne shpenzimet. Sa i përket shërbime tjera kontraktuese ka ardhur si kërkesë prej asamblesë komunale ku është kërkuar sqarime se ka shumë te madhe, ku ne këtë kategori nuk ka kod te veçantë me i nda dhe hynë transporti i nxënësve, kontrata me “Caritasin”, shërbime printimi etj, por mundemi mi nxjerr raportin e veçantë nga “Free Balanci”, dhe janë specifikuar për secilat shpenzime dhe kategori, pagesat e bëra.

z. Arten Hamza: Po kryetar ky është raporti i buxhetit do ta diskutojmë këtë pjesë kur të dalim të pika e rrjedhës së parasë ndërsa sa i përket obligimeve kontraktuale që janë me kontrata janë të prezantuara edhe ne Ministrinë e Financave dhe ne takimin e këshillit të drejtorëve që ju informova në takimin e parë, për shembull të shpenzimet të subvencionet janë 21.550 .00€ totali 1,500€ për OJQ 20.000.00€ të rastet shëndetësore nuk duhet të publikohen po për institucion lejohen, të komisioni që është marrur me shqyrtimin e kërkesave. Gjithashtu nuk janë të raportuar 7400€ janë obligime që janë shqyrtuara nga Komisioni për rastet të infektuar me COVID-19, raporti është për gatitur nga Komisioni por nuk ka një vendim apo diçka tjetër, obligime kemi edhe të 103 studentet që për secilën student është parapara nga 250 € .

Ndërsa sa i për ketë të hyrat nga të farkëtueshme që janë inkasime që bëhen pagesat nga qytetarët nga tatimi në prone dhe nga bizneset si dhe nga qiraja e një antene me valën në objektin e komunës si dhe qiraja e fabrikës së ujit “Juniku” është 550 € në vit ku për dy vite është realizuar pagesa, dhe për 3 vite i ka borxh komunës, totali i qeras në vit është 3,172.00, gjithsej totali i të argëtueshmeve është 2,42623, që i presim por vitin e kaluar nuk kemi mundur për shkak të pandemisë nuk është marr ndonjë aktivitet me përmbaues duhet Komuna me gjetur formë për të bindur qytetarët me të kryer obligimet, unë kaq kisha sa i përket kësaj pike, jam i gatshëm të pres pyetje nga ju.

z. Leonard Llojuni: Meqenëse u përmenden disa obligime lidhur me kontratat e nënshkruara afër 800.000.00€ kishte qenë mirë ti sjellni dhe ti shohim në Kuvend.

z. Arten Hamza: Unë do të lexoj projektet kontraktuale që kemi obligime me operatorët ekonomik që janë të nënshkruara:

Hapja rrugëve fushore, Transporti i nxënësve lagje “Agim Ramadani” shkollë e mesme, asfaltimi i rrugëve lokale, rrehabilitimi i rrugëve lokale, ndërtimi i qendrës kulturore të qendrës së agrobiznesit, rregullimit i shtratit të lumit 2 Erenik”, hartimi i hartës zonale dhe plani zhvillimor Komunal, ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravic, Obligimet me Caritasin Kosova për ofrimin e shërbimeve, Memoriali i “Dëshmorëve të Junikut”, ndërtimi i ujësjellësit në lagjen “Agim Ramadani”, ndërtimi i parkut të lodrave për fëmijë, asfaltimi i rrugës lokale Junik-Jasiq, këto janë disa nga kontratat e nënshkruara me operatorët ekonomik.

z. Leonard Llojuni: Përshembull të asfaltimi i rrugës Junik-Jasiq apo të qendra Kulturore e Agro Biznesit nuk mund të quani borgje, derisa nuk ka përfunduar projekti.

z. Arten Hamza: Ndoshta edhe jemi keqkuptuar por unë e potencova se janë obligime kontraktuale të pa përfunduara, por ju nëse doni që në seancën e ardhshme në bashkëpunim me prokurimin, mund të sjellim raport të veçantë.

Pika e pestë e rendit të Ditës

5. Rishiqimi i propozimit për Komitetin për Komunitete,

z. Shpejtim Gacaferi: Siq jeni në dijeni ne e kemi formuar këtë komitet sipas obligimeve ligjore, e kemi dërguar në MAPL por është refuzuar dhe është dërguar për rishqyrtim në kuvend, ky komitet është kërkuar që të respektohet baza ligjore dhe duhet të formohet nga anëtarët e asamblesë komunale shoqëria civile, dhe nga komuniteti i biznesit.

z. Leonard Lolluni: Unë propozoj **z. Zenel Malokun** për anëtar të Komitetit të Komuniteteve.

z. Sadri Krasniqi: ne mbesim me propozimin e njejt znj. Zejnepe Gaxherri.

z. Xheme Tofaj: Kryesues edhe ne mbesim me propozimin e njëjtë znj. Eliza Pepshi.

z. Shpejtim Gacaferi: Sa i përket dy anëtarëve të tjerë nga Komuniteti i Biznesit kemi propozim **z. Valdrin Isufaj**, nga Shoqëria Civile kemi znj. Safete Shehu.

Hodhi në votim, a jeni për këtë përbërje.

Nga 14 prezent, për ishin 14, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Pika e gjashtë e rendit të ditës

6. Me kërkesën e kryetarit të Komunës pikë shtesë nxjerrja e vendimit për formimin e Komitetit të KKSB-së

z. Shpejtim Gacaferi: Sa i përket kësaj pike ne duhet ta nxjerrim vendimin për formimin e KKSB-së, me udhëzim administrativë këshilli përbehet nga këta përfaqësues:

1. Kryetari i Komunës,
2. Komandanti i Stacionit të policisë,
3. Drejtori për Arsim,
4. Përfaqësuesi fetar nga Komuna përkatëse,

5. Përfaqësuesi i Komunitetit Etnik,
6. Zyrtari Për Barazi Gjinore,
7. Kryetari i këshillit të prindërve,
8. Një përfaqësues i FSK-së
9. Përfaqësuesi i ekipit për siguri në bashkësi,
9. Përfaqësuesi i emergjencave civile,
10. Përfaqësuesi i zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
11. Përfaqësuesi i Komunitetit të Biznesit,
12. Përfaqësuesi nga Shoqëria Civile,
13. Kryesuesi i komitetit për Komunitete,
14. Përfaqësuesi i personave me aftësi të kufizuar,
15. Përfaqësuesi për siguri publike.

Kush jeni për nxjerrjen e vendimit për përbërjen e këtij këshilli?

E hedhi në votim.

Nga 14 prezent, për ishin 14, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Pika e shtatë e rendit të ditës

5. Të ndryshme,

z. Shpejtim Gacaferi: Sa i përket kësaj pike e hapi debatin për diskutime.

z. Zenel Maloku: Deshta të lidhem të rruga Junik- Jasiq u përmend shumë por është bo si “Lahuta e Malësisë”, deshta të di rruga për bjeshkë a fillon prej Gjocaj a prej Junikut? Por rruga për Jasiq ka mbetur të rampa e vjetër, operatori paska lyp mjete shtesë unë nuk di çka po don me bo për punë shtesë, por ai s’ka filluar me punuar fare por është rruga tjetër për Jasiq qe ka me filluar prej hoteli të laura e përpjetë. Apo ku kisha kërkuar prej juve të më ndihmoni pak të kjo pjesë, gjithashtu e kom një pyetje për Drejtorin e Urbanizmit e kom pas një kërkesë për ne lagje të shtëpia e parë a kanë biseduar mi hequr atë problem sepse shikueshmëria nuk është në nivel, a është marr ndonjë iniciativë ne këtë drejtim .

z. Demokrat Ganija: Faleminderit kryesues kërkesat e parashtruara nga z. Zenel Maloku njëra për zhurmën e krijuar nga “fabrika e Peletit” në Lagjen “Agim Ramadani” është larguar dhe tjetra zhbllokimi i pesetës po ashtu në lagjen “Agim Ramadani” është rregulluar, ndërsa kërkesa e tretë është ne procedurë e sipër për ty rregulluar.

z. Leonard Llolluni: Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike, kohëve të fundit kemi dëgjuar shqetësime nga qytetaret që një biznes ka filluar me operuar që e quajmë ne në rrugën e Begut, ky lloj biznesi a i është bërë inspektimi lidhur me veprimtarinë të cilën operon, a i është dhënë leja edhe ne jemi ne dijeni se ne vitin 2020 prokuroria speciale në Pejë ka marr vendim për mbylljen e te gjitha këtyre bizneseve. Çfarë hapash keni marr ne këtë drejtim.

z. Demokrat Ganija: Fillimisht ka ardhur një biznes i cili nuk ka kërkuar fare leje te ne, ndërsa ne në bashkëpunim me policinë ne Junik brenda 48 orëve e kemi bërë mbylljen e këtij biznesi. Pastaj ka ardhur nje operator tjetër që ka kërkuar leje për shërbim te pijeve inspektorët kanë bërë punën e tyre dhe nuk ka devijuar nga leja te cilën e ka kërkuar, ndërsa me vonë kemi pranuar një ankesë nga qytetaret se është duke prishur rendin me muzikën e me zë të lart, ne kemi shkuar bashkë me policinë por nuk kemi vërejt diçka ne kundërshtim me veprimtarinë, por ne çdo ditë jemi duke monitoruar ne bashkëpunim me policinë që ne momentin që e vërejmë që ka devijimin nga aktiviteti te cilin ka marr leje, ne do te veprojmë shpejt sipas procedurave ligjore.

znj. Rajmonda Krasniqi: Unë desha të potencoj problemin lidhur me qentë endacak në rrugë ku është bërë problem serioz, asnjë ditë nuk munden fëmijët të shkojnë në shkollë pa përcjellje, kisha kërkuar nga ju që të merrni masa të me njëhershme.


z. Ruzhdi Shehu: Shumë e vërtetë shqetësim me vend, ky shqetësim është ne nivel vendi, unë shpresoj që shumë shpejt do te zgjidhet ky problem, sepse është krijuar një grup punues që të hartohet një plan për të vepruar dhe të bëhet zgjidhja e këtij problemi, por po apeloj nga ju që te keni kujdes në këtë drejtim.

z. Shpejtim Gacaferi: E shpalli të mbyllur mbledhjen e tretë të Kuvendit Komunal në Junik, ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:30.

Procesmbajtësi:

z. Arton Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

